



UNMIK/DIR/2005/4  
18 shkurt 2005

---

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2005/4**

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2000/36 MBI  
LICENCIMIN DHE RREGULLIMIN E MEDIAVE TRANSMETUESE NË  
KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 6 të Rregullores nr. 2000/36 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 17 qershor 2000 mbi Licencimin dhe rregullimin e mediave transmetuese në Kosovë,

Me qëllim të qartësimit të fushës së zbatimit të nenit 2.1 dhe 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/36.

Me anë të kësaj shpall këtëUrdhëresë administrative:

Neni 1

Fusha e zbatimit të nenit 2.1 dhe 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/36

- 2.1 Në nenin 2.1 shprehja “operatorët për radio dhe television” përfshin edhe transmetuesit kabllorik.
- 2.2 Neni 3.1 i mundëson komisionerit të përkohshëm për media që të shqiptojë një apo më tepër sanksione të parapara në të ndaj personave të licencuar për transmetim, të cilët nuk iu përmbahen kushteve dhe detyrimeve të licencës për transmetim të lëshuar nga komisioneri i përkohshëm për media.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 18 shkurt 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

